

UDHËZIM
Nr. 18, datë 27.6.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 7.3.2024,
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024” dhe të pikës 5, të VKM-së nr. 130, datë 6.3.2024, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2024”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun VI, “Kriteret specifike dhe dokumentacioni i nevojshëm për masat mbështetëse, bëhen ndryshimet si vijon:

a) në masat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, nënndarja “ii”, togfjalëshi “20 ditë kalendarike” zëvendësohet me togfjalëshin “datës 31 korrik 2024”;

b) në masën 6, nënndarja “ii”, togfjalëshi “15 ditë kalendarike” zëvendësohet me togfjalëshin “datës 31 korrik 2024”.

2. Në kreun VII, “Procedurat që do të ndiqen për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1-7”, në pikën 4, bëhet ndryshimi si vijon:

Togfjalëshi “20 ditë kalendarike nga data e shpalljes së listës” zëvendësohet me togfjalëshin “31 korrik 2024...”.

3. Në kreun VIII, “Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për masën 8: mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi – aplikimi për mbështetje për naftën për bujqësinë”, në pikën 13, shtohet paragrafi, me formulimin si vijon:

“Gjithashtu, të vlefshme do të konsiderohen edhe rastet kur dokumentet e sipërcituara nënshkruhen nga njëri prej anëtarëve të familjes bujqësore në gjendjen aktuale.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

MINISTËR I FINANCEVE
Ervin Mete